



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:271957

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05716113

C. nr.925/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Th. nga të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vlora Kadriu, avokate nga Gjilani, kundër të paditures Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin në bazë të inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia me numër C.nr.925/2023, e datës 29.11.2023, e paditësit A. Th. nga, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, lidhur me çështjen juridike kontestimore për kompensimin në bazë të invlacionit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi A.Th. nga, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 29.11.2023, në këtë gjykatë ka ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, me objekt kontesti kompensimin në bazë të inflacionit, me vlerë të kontestit prej 750.48 euro.

Përfaqësuesi i paditësit, përmesë parashtresës së datës 24.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë me arsyetimin se për të njëjten çështje juridike është paraqitur padi nga një avokat tjetër dhe se janë dakorduar me palën paditëse që ta tërheqë padinë, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:271957, 21.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli,d.v.

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2023:271957
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05716113